



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

Legjislatura VIII  
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit

P-033

Prishtinë, më 21 prill 2022, në orën 11:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

IMBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 21 PRILL 2022

**Në mbledhje morën pjesë:** Glauk Konjufca, kryetar i Kuvendit; Saranda Bogujevci, Enver Hoxhaj, Slavko Simiq dhe Bekim Arifi, nënkryetarë të Kuvendit.

**Nga grupet parlamentare në mbledhje morën pjesë:** Mimoza Kusari-Lila, Abelard Tahiri, Arben Gashi, Besnik Tahiri dhe Enis Kervan.

**Në mbledhje ishin të pranishëm:** Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, Ismet Krasniqi, si dhe stafi përgjegjës në mbështetje të Kryesisë së Kuvendit.

Mbledhjen e drejtoi Glauk Konjufca, kryetar i Kuvendit.

Me propozimin e kryetarit, Kryesia i zhvilloi punimet me këtë:

#### Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme të Kryesisë së Kuvendit, e mbajtur më 8 prill 2022,
2. Pika e papërfunduar nga seanca plenare, e mbajtur më 22, 23, 24 shkurt, 16 mars dhe 14 prill 2022,
3. Pika e papërfunduar nga seanca plenare, e mbajtur më 24, 25 shkurt, 16 mars dhe 14 prill 2022,
4. Pika e papërfunduar nga seanca plenare, e mbajtur më 7 dhe 14 prill 2022,
5. Pika e papërfunduar nga seanca plenare, e mbajtur më 12 prill 2022,
6. Pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 14 dhe 19 prill 2022,
7. Përgatitjet për seancën plenare të radhës,
8. Shqyrtimi i propozimeve dhe i kërkesave.

\* \* \*

Në fillim, kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, e shtroi çështjen e mocionit të kryetarit të GP të PDK-së, Abelard Tahiri, në emër të 40 deputetëve, të paraqitur në seancën plenare, e mbajtur më 19 prill 2022, për themelimin e Komisionit Hetimor Parlamentar lidhur me menaxhimin e krizës energjetike nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Diskutimi i plotë i kryetarit është dhënë në transkript.

Në lidhje me çështjen e lartshënuar, diskutuan: kryetari i GP të LDK-së, Arben Gashi; kryetari i GP të PDK-së, Abelard Tahiri; kryetarja e GP të LVV-së, Mimoza Kusari-Lila; kryetari i GP të AAK-së, Besnik Tahiri; kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, dhe nënkryetarët e Kuvendit: Enver Hoxhaj e Slavko Simiq, si dhe Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, Ismet Krasniqi, i cili dha sqarime në lidhje me çështjen e zgjedhjes së kryesuesit të komisionit hetimor parlamentar, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas diskutimeve të lartshënuara, Kryesia vendosi që propozimi i 40 deputetëve për caktimin e Komisionit Hetimor Parlamentar lidhur me menaxhimin e krizës energjetike nga Qeveria e Republikës së Kosovës të radhitet në rendin e ditës të seancës plenare, e cila do të mbahet më 28 prill 2022.

\* \* \*

Pastaj kryetari procedoi me pikat e rendit të ditës:

**1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme të Kryesisë së Kuvendit, e mbajtur më 8 prill 2022**

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, e mbajtur më 8 prill 2022.

**2. Pika e papërfunduar nga seanca plenare, e mbajtur më 22, 23, 24 shkurt, 16 mars dhe 14 prill 2022,**

**3. Pika e papërfunduar nga seanca plenare, e mbajtur më 24, 25 shkurt, 16 mars dhe 14 prill 2022,**

**4. Pika e papërfunduar nga seanca plenare, e mbajtur më 7 dhe 14 prill 2022,**

**5. Pika e papërfunduar nga seanca plenare, e mbajtur më 12 prill 2022,**

**6. Pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 14 dhe 19 prill 2022,**

Kryesia nuk vendosi për datën e vazhdimit të seancave plenare, me pikat e papërfunduara të lartshënuara, nr. 2 - 6.

**7. Përgatitjet për seancën plenare të radhës**

Kryesia, pasi i shqyrtoi përgatitjet e nevojshme dhe pas diskutimeve, vendosi që seanca plenare e radhës e Kuvendit të Republikës së Kosovës të mbahet të enjten, më 28 prill 2022, në orën 10:00, me këtë:

*Rend dite*

- 1. Deklarimet jashtë rendit të ditës,*
- 2. Pyetjet parlamentare,*
- 3. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme,*
- 4. Propozimi i 40 deputetëve për caktimin e Komisionit Hetimor Parlamentar lidhur me menaxhimin e krizës energjetike nga Qeveria e Republikës së Kosovës,*
- 5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-076 për mbrojtjen e sekreteve tregtare,*
- 6. Zgjedhja e një (1) anëtari të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga radhët e komuniteteve tjera joshumicë,*
- 7. Zgjedhja e tre (3) anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës,*
- 8. Formimi i Organit Përzgjedhës të Pavarur për përzgjedhjen e anëtarëve në Organin Shqyrtues të Prokurimit.*

Ndërsa, me propozim të kryetarit të GP të PDK-së, Abelard Tahiri, në cilësinë e iniciuesit, Kryesia e shtyu për seancën plenare të radhës pikën: Debat parlamentar për punën e Qeverisë së Republikës së Kosovës në vitin e parë të mandatit të saj.

## **8. Shqyrtimi i propozimeve dhe i kërkesave:**

### *1. Procedimi i Projektligjit për shëndetësi*

Kryesia, në lidhje me procedimin e nismës legislative për Projektligjin për shëndetësi, nxori këtë:

#### **P Ë R F U N D I M**

Kërkohej nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të paraqesë mendim lidhur me nismën legislative të dhjetë (10) deputetëve të Kuvendit të Kosovës “Projektligji për shëndetësi”, si dhe të përgatisë Deklaratën e ndikimit buxhetor dhe Deklaratën për përafrim me legjislacionin e BE-së të këtij projektligji në afatin prej një (1) muaji nga dita e pranimi.

### *2. Kërkesa e Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit për lejimin e udhëtimit zyrtar në Kopenhagë (Danimarkë)*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

#### **V E N D I M**

1. Deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës: Adnan Rustemi, Driton Selmanaj, Dimal Basha, Blerta Deliu-Kodra, Besnik Tahiri dhe Erxhan Galushi u lejohet udhëtimi zyrtar në Kopenhagë (Danimarkë), prej 4 - 7 maj 2022.

2. Të gjitha shpenzimet e udhëtimit, të akomodimit dhe mëditjet për të lartshënuarit në pikën një (1) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

### *3. Kërkesa për mbulimin e shpenzimeve shtesë për akomodim, në lidhje me udhëtimin zyrtar në Venecia (Itali), prej 20 - 23 prill 2022*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

#### **V E N D I M**

Lejohet mbulimi i tejkalimit të shpenzimeve të akomodimit të delegacionit të Kuvendit të Republikës së Kosovës: Eliza Hoxha, Ardian Gola dhe Vlora Dumoshi, lidhur me udhëtimin zyrtar në Venecia (Itali), nga 20 - 23 prill 2022.

### *4. Kërkesa e kryetares së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur, Viktimat e Dhunës Seksuale të Luftës dhe Peticione, për mbulimin e shpenzimeve të akomodimit për znj. Natasha Kandiç dhe një shoqëruar*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

## V E N D I M

Znj. Natasha Kandiç dhe një shoqëruesi të saj i mbulohen shpenzimet e akomodimit dhe i rimbursohen shpenzimet e transportit për vizitën e tyre në Kosovë, prej 19 - 20 prill 2022, për pjesëmarrjen në tryezën për të pagjeturit, të realizuar në Kuvendin e Kosovës, më 20 prill 2022.

*5. Kërkesa për lejim të pjesëmarrjes së delegacionit të Përherëshëm të Kuvendit të Republikës së Kosovës në Sesionin Pranveror të Asamblesë Parlamentare (AP) të NATO-s, në Lituani, nga 27 - 31 maj 2022*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

## V E N D I M

1. Deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës: Driton Hyseni dhe Xhavit Haliti u lejohet udhëtimi zyrtar në Vilnius (Lituani), prej 27 - 31 maj 2022.
2. Të gjitha shpenzimet e udhëtimit, të akomodimit me tejkallim të mundshëm të tarifës së caktuar për fjetje për Lituani dhe mëditjet për të lartshënuarit në pikën një (1) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

*6. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Chania (Greqi) nga 15 - 18 maj 2022 - pjesëmarrje në Komitetin për Çështje Politike dhe Demokraci*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

## V E N D I M

1. Deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës: Saranda Bogujevci dhe Arben Gashi u lejohet udhëtimi zyrtar në Chania (Greqi), prej 15 - 18 maj 2022.
2. Të gjitha shpenzimet e udhëtimit, të akomodimit me tejkallim të mundshëm të shpenzimeve dhe mëditjet për të lartshënuarit në pikën një (1) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

\* \* \*

Nënkryetarja e Kuvendit, Saranda Bogujevci, kryesuese e Delegacionit në Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, kërkoi nga Administrata e Kuvendit që ta përgatisë një propozim që këtij delegacioni Kryesia e Kuvendit t'ia lejojë udhëtimet zyrtare gjatë vitit 2022 për pjesëmarrjen në aktivitetet e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, ndërsa udhëtimet e veçanta të këtij delegacioni të lejohen me vendim të kryetarit të Kuvendit.

Diskutimi i znj. Bogujevci është dhënë në transkript.

\* \* \*

*7. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Strasburg (Francë) nga 24 - 29 prill 2022 - pjesëmarrje në Sesionin e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës - Pjesa e Prillit 2022*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

#### V E N D I M

1. Deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës: Saranda Bogujevci, Enis Kervan, Ariana Musliu-Shoshi dhe Besnik Tahiri u lejohet udhëtimi zyrtar në Strasburg (Francë), prej 24 - 29 prill 2022.
2. Të gjitha shpenzimet e udhëtimit, të akomodimit me tejkalim të mundshëm të shpenzimeve, avanci në vlerën prej 1 000,00 euro për nevojat e delegacionit dhe mëditjet për të lartshënuarit në pikën një (1) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

*8. Raporti i kryetarit të Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit në lidhje me vizitën e delegacionit, e realizuar në Hagë (Holandë)*

Kryesia e Kuvendit është njoftuar me shkrim nga kryetari i Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, Adnan Rrustemi, në lidhje me vizitën zyrtare të një delegacioni të Kuvendit, e realizuar në Hagë (Holandë), nga 29 mars - 1 prill 2022.

*9. Kërkesa për lejimin e vizitës zyrtare të Delegacionit të Përherëshëm të Kuvendit të Republikës së Kosovës në Asamblesë Parlamentare (AP) të NATO-s në Bosnjë-Hercegovinë, nga 6 - 10 qershor 2022*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

#### V E N D I M

1. Deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës: Driton Hyseni dhe Xhavit Haliti u lejohet udhëtimi zyrtar në Sarajevë (Bosnjë-Hercegovinë), prej 6 - 10 qershor 2022.
2. Të gjitha shpenzimet e udhëtimit, të akomodimit dhe mëditjet për të lartshënuarit në pikën një (1) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

*10. Kërkesa për kompensimin e shpenzimeve për udhëtimin e realizuar në Austri*

Kryesia, pasi i shqyrtoi kërkesat e lartshënuar, mori këtë:

## V E N D I M

Deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës: Enver Hoxhaj dhe Ardian Gola u kompensohen të gjitha shpenzimet e udhëtimit, akomodimit dhe mëditjet në lidhje me udhëtimin zyrtar të realizuar në Vjenë (Austri), prej 30 - 31 mars 2022.

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë në orën 12:55 minuta.

Glauk KONJUFCA

---

Kryetar i Kuvendit

*Procesverbalin e hartoi:*

*Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale*